



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 106, Datë 21.04.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SPV
BLUE 3” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.04.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1101/1 prot., datë 17.04.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 3” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “SPV Blue 3” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1101 prot., datë 08.04.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik “Blue 3”, me vendndodhje në Sheq Marinas, me kapacitet të instaluar 36 MWac, për një afat 30-vjeçar.
- Shoqëria ka kërkuar që afati 30-vjeçar të fillojë me operimin e veprës, pas kalimit të provës 72-orëshe të testimiit dhe komisionimit nga OST sh.a. Sa kërkuar nga shoqëria vlerësohet se mbështetet dhe në marrëveshjen e zhvillimit të Projektit me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), ku afati lidhet me datën e operimit tregtar apo kolaudimin e veprës, ndaj në rast licencimi të shoqërisë, afati i vlefshmërisë së licencës do të fillojë pas komisionimit nga OST sh.a.

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në referencë të përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe ka plotësuar dokumentacionin si vijon:
- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas gërmave a, b dhe c, duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën 1.

- Në përputhje me nenin 9, pikën 1.2 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas gërmave a, b dhe d.
- Në përputhje me nenin 9, pikën 1.3 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas gërmës b.
- Në përputhje me nenin 9, pikën 2 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencim në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas gërmave c, d dhe e.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

Shoqëria “SPV Blue 3” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “*Marrëveshjen për Zhvillimin e Projektit në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e Impiantit Fotovoltaik “Blue 3” me një kapacitet të instaluar prej 36 MWac dhe Kapacitet të Mbështetur prej 36 MWac që do vendoset në Sheq Marinas, Fier*”, me nr. 6122/3 prot., datë 10.12.2024;
- Ka nënshkruar me Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. “*Marrëveshjen për lidhjen në rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaik “Blue 3”*”, me nr. 3508/6 prot., datë 24.10.2025;
- Është pajisur me VNM Paraprake, nr. AN090720250011, datë 29.10.2025 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “*PARKU FOTOVOLTAIK- Blue 3*”.
- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “c”**: Aplikuesi duhet të bëjë me dije nëse stafi i përcaktuar në strukturën organizative është aktualisht efektiv.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “a”**: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve për shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
- **gërma “c”**: Aplikuesi duhet të japë informacionin/argumentet përkatëse mbi periudhën për të cilën janë bërë parashikimet në planin e biznesit dhe/ose depozitimim e planit të biznesit të përditësuar.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1

- **gërma “a”**: Aplikuesi duhet të saktësojë kapacitetin e instaluar të njësive gjeneruese, si dhe të depozitojë garanci për panelet që do të përdorë, në rast se e disponon, në mënyrë që të rakordohen dhe afatet e vlefshmërisë së licencës.
- **gërma “b”**: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE komunikimet me MIE-n, në lidhje me krijimin e shoqërisë për qëllime të veçanta (SPV), të depozitojë në ERE qëndrimin e MIE-s, (në rast se ka pasur një të tillë), si dhe të bëjë me dije në rast se e ka nënshkruar Marrëveshjen

Përfundimtare dhe ta depozitohet atë në ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SPV Blue 3” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik “Blue 3”, me kapacitet të instaluar 36 MWac, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 3” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI